



## Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	Community Leadership
Vlera e projektit:	€ 15,234.00
Kohëzgjatja:	Fillimi: 01/10/2016 Përfundimi: 30/09/2017
Organizata implementuese:	George Williams Youth Association in Kosovo (GWYA)
Kontaktet e Organizatë (adresa, e-maili, telefonat):	Dorina Davies, <a href="mailto:georgewilliamsyouthassociation@gmail.com">georgewilliamsyouthassociation@gmail.com</a> , +377 45 543 673, +377 45 695 429 <a href="http://ymcainkosovo.wix.com/ymcakosovo">http://ymcainkosovo.wix.com/ymcakosovo</a> Rr. Ismail Qemali p.n, Gjakovë 50 000 Kosovë
Përfituesit e drejtëpërdrejtë:	Grupet e synuara: Të rinjtë dhe te rejat nga mosha 14-20 vjeq në Komunën e Junikut Përfituesit final: 60 të rinjë nga Komuna e Junikut. .
Partnerët:	N/A
Territori i synuar/shtrirja gjeografike:	Komuna e Junikut
Qëllimi i përgjithshëm:	Qëllimi i këtij projekti është trajnimi dhe fuqizimi i të rinjëve të Junikut, dhe të ndihmojmë infrastrukturën e qeverisjes lokale në departamentin e rinisë që të përkrahë aktivizimin e të rinjëve në aspektin afatgjatë.
Aktivitetet kryesore:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i 3 grupeve të të rinjëve me nga 20 pjesmarrës në secilin prej tyre, në total 60 të rinjë për një vit. Do të organizojmë trajnime javore për tema të ndryshme që shqetësojnë komunitetin dhe që do të ndihmojnë të rinjtë të avokojnë për ndryshime sociale në Komunën e Junikut. Secili grup do të kalojë nëpër tri nivelet e trajnimit me nga 10 sesione për nivel, gjithsej 30-ditë trajnime për secilin grup dhe pastaj si efekti i rrjedhshmërisë së ujarës ata do të kenë mundësinë të hapin vetë një grup dhe të bëhen trajnerë bashkëmoshatar, duke krijuar më shumë grupe të udhëhequra nga të rinjtë do të sigurohet qëndrueshmëri për projektin por gjithashtu do të ju jepet mundësia të rinjëve të udhëheqin. Për secilin nivel të trajnimeve ata do të kenë një sfidë, për të ndërmarrë një iniciativë për një projekt në komunitet që do të stimulonte pjesmarrjen dhe aktivizimin qytetar.</li> <li>2. Do të organizohen 2 tryeza të rrumbullakëta me Media, Departamentin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Junikut dhe Shkollat me temat a) pjesmarrja e të rinjëve në vendimmarrje në Komunën e Junikut dhe Plani i Veprimit për Rini; dhe b) nën-kodi për buxhetin e Departamentit për Rini dhe njohja e potencialit të të rinjëve për punë vullnetare në komunitet.</li> <li>3. Do të organizojmë 3 takime me Kryetarin e Komunës së Junikut, nga një takim për secilin grup për të biseduar për shqetësimet e të rinjëve dhe sygjerimet që ata mund të i kenë për komunën.</li> <li>4. Do të bëjmë një hulumtim me të gjithë të rinjtë e shkollës së mesme në Junik në mënyrë që të kuptojmë situatën e tyre dhe do të publikojmë një raport për këtë . Ky raport do të ndihmojë në ridizajnimin e Planit të Veprimit për Rini në Junik duke u bazuar në nevojat e të rinjëve, që do të shërbente si një platformë për aktivitetet e të rinjëve për vitet 2017-2019.</li> </ol>
Rezultatet e pritura:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 60 të rinjë do të përfundojnë 3 nivelet e trajnimit dhe do të implementohen 9 projekte të vogla në komunitet për një vit.</li> <li>2. Do të organizohen 2 tryeza të rrumbullakëta për qështjet e të rinjëve dhe rekomandimet do të i dergohen zyrës së Kryetarit të Komunës.</li> <li>3. Për herë të parë do të bëhet një hulumtim për situatën e të rinjëve në Komunën e Junikut.</li> <li>4. Do të ndihmojmë në ridizajnimin e Planit të Veprimit për Rini për vitet 2017-2019 duke i përfshirë të gjithë akterët kryesorë për zhvillimin e të rinjëve në Komunë e Junikut.</li> <li>5. 3 takime të të rinjëve me kryetarin e Komunës së Junikut. Secili Grup do të ketë një takim për të shprehur shqetësimet e tyre dhe sygjerimet për komunën nga perspektiva e të rinjëve.</li> </ol>

